

Etika publike

Transparenca dhe qeveria e hapur

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale
të Këshillit të Evropës

The Congress



Le Congrès

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Transparenca dhe qeveria e hapur

Komiteti për Qeverisje

Raportuesi:¹

Andreas GALSTER, Gjermani (L, EPP/CCE)

¹ L: Dhoma e Autoriteteve Lokale / R: Dhoma e Rajoneve
EPP/CCE: Grupi i partive popullore evropiane në Kongres
SOC: Grupi socialist
ILDG: Grupi i pavarur dhe i liberal demokratëve
ECR: Grupi i konservatorëve dhe reformatörëve evropianë
NR: Anëtarë që nuk i përkasin asnjë grupi politik të Kongresit

Përmbajtja

Përmbledhje	5
REZOLUTA 435 (2018)	6
REKOMANDIMI 424 (2018)	11
MEMORANDUM SHPJEGUES	16
1. Hyrje	17
2. Elemente përshkuese të qeverisë së hapur	28
3. Korniza për qeveri të hapur lokale	37
4. Buxhetimi i hapur lokal	39
5. Kontraktimi i hapur lokal	43
6. Ligj-bërja lokale e hapur	48
7. Ofrimi i shërbimeve lokale të hapura	51
8. Rekomandimet për qeveri të hapur lokale	56
9. Rekomandimet për qeveri të hapur lokale	61
SHTOJCA: LEXIM SHITESË	63

Përmbledhje

Transparenca dhe qeveria e hapur është një nga prioritetet që Kongresi i identifikoi në Udhërrëfyesin e tij të aktiviteteve mbi 'parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivelet lokale dhe rajonale', që u miratua në sesionin e 31-të, në tetor 2016.

Ky raport thekson potencialin e qeverisjes së hapur për të përmirësuar demokracinë në nivelet lokale dhe rajonale. Ai eksploron konceptin e 'Qeverisë së Hapur' dhe identifikon aktivitetet e qeverisjes lokale në të cilat mund të zbatohet, siç janë buxhetimi, ligj-bërja, politikë-bërja, kontraktimi dhe ofrimi i shërbimeve.

Në rezolutën e tij, Kongresi fton autoritetet lokale dhe rajonale të miratojnë dhe zbatojnë standarde të qeverisë së hapur dhe të organizojnë kurse trajnimi në administratat e tyre për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e transparencës. Ai u bën thirrje atyre që të promovojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike lokale, në veçanti duke e inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në politikat e tyre dhe proceset e vendimmarrjes dhe duke promovuar përfshirjen e qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve buxhetore dhe vlerësimin e kontratave të prokurimit.

Në rekomandimin e tij, ai i kërkon Komitetit të Ministrave t'iu bëjnë thirrje qeverive që të inkurajojnë autoritetet lokale dhe rajonale të publikojnë dokumente dhe informacione kyçe, të promovojnë proceset e konsultimit publik dhe të mbështesin monitorimin dhe zbatimin e masave të transparencës.

Rezoluta 435 (2018) 2

1. Transparenca dhe qeveria e hapur është njëra nga fushat prioritare që Kongresi i identifikoi në Udhërrëfyesin e tij të aktiviteteve për 'parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivelet lokale dhe rajonale' që u miratua në sesionin e tij të 31^{-të}, tetor 2016.

2. Koncepti i Qeverisë së Hapur 'përfshin një gamë të gjerë praktikash, të cilat mund të çojnë drejt mënyrave të reja të qeverisjes, si nga këndvështrimi i qeverive ashtu edhe nga ai i qytetarëve. Ai mund të promovojë qeverisje të mirë dhe të inkurajojë vendimmarrje më të mirë. Duke ndihmuar në uljen e korrupsionit ose në promovimin e shërbimeve më efektive, qeveria e hapur është një mjet i fuqishëm për të trajtuar disa nga problemet që mund të hasë demokracia lokale.

3. Transparenca, pjesëmarrja dhe llogaridhënia, parimet kryesore të qeverisë së hapur, kërkojnë risi nga autoritetet lokale dhe rajonale në ndërveprimin e tyre me qytetarët dhe mënyrën se si ata i menaxhojnë administratat e tyre. Transparenca kërkon që autoritetet të lehtësojnë qasjen e qytetarëve në informacion, veçanërisht përmes të dhënave të hapura dhe menaxhimit të regjistrave. Duhet të shkojë paralelisht me

² E debatuar dhe miratuar nga Kongresi më 7 nëntor 2018, mbledhja e 2-të, (shih Dokumentin [CG35\(2018\)14](#), memorandum shpjegues), raportuesi Andreas GALSTER, Gjermani (L, EPP/CCE).

pjesëmarrjen më të madhe të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes publike, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve. Kësaj rritjeje të pjesëmarrjes duhet t'i shtohet edhe llogaridhënia më e madhe e autoriteteve, përmes përdorimit të auditimeve, kodeve të etikës dhe vëzhgimit publik.

4. Një strategji e 'Qeverisë së Hapur' mund të zbatohet për një gamë të gjerë aktiviteteve qeveritare, duke përfshirë jo vetëm buxhetimin, ligj-bërjen dhe politikë-bërjen, por edhe fusha të tilla si kontraktimi dhe ofrimi i shërbimeve, ku autoritetet lokale dhe rajonale shpesh punojnë me partnerët dhe palët tona të interesit.

5. Në dritën e konsideratave të mësipërme, Kongresi:

a. duke pasur parasysh

- i.** Rezolutën 417 të Kongresit dhe Rekomandimin 398 (2017) mbi të dhënat e hapura për shërbime më të mira publike;
- ii.** Rezolutën 421 të Kongresit dhe Rekomandimin 405 (2017) mbi Bërjen transparente të prokurimit publik në nivelet lokale dhe rajonale;
- iii.** "Udhëzimet për pjesëmarrjen civile në vendimmarrjen politike" (2017) të Këshillit të Evropës;
- iv.** 12 parimet e qeverisjes së mirë (2008) të Këshillit të Evropës;
- v.** Doracakun e Këshillit të Evropës për Etikën Publike në Nivelin Lokal (2004);
- vi.** Kodin e praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes (2009, Konferenca e OJQ-ve e Këshillit të Evropës);
- vii.** Rekomandimin e OBZHE-së të Këshillit për Qeverinë e Hapur (2017)

- viii.** Kartën Ndërkombëtare të të Dhënave të Hapura (2015), të miratuar në Samitin global të partneritetit për qeveri të hapur;
- b.** i bindur se qeveria e hapur dhe transparenca janë një mundësi që qeverisja lokale të jetë më demokratike;
- c.** i bindur se një proces i hapur i vendimmarrjes është mjet efektiv për të zhvilluar dhe zbatuar politika më efektive publike;
- d.** i vetëdijshëm për sfidat e autoriteteve lokale për t'iu adresuar të gjithë qytetarëve, veçanërisht atyre që vuanë nga një hendek digjital;
- e.** i vetëdijshëm për rëndësinë e respektimit të ligjeve të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

6. Fton autoritetet lokale dhe rajonale në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që të:

- a.** miratojnë dhe zbatojnë standarde për qeveri të hapur, në veçanti duke:
 - i.** u nisur nga dispozitat kryesore të Kartës Ndërkombëtare të të Dhënave të Hapura dhe Standardit të të Dhënave të Kontraktimit të Hapur;
 - ii.** mbështetur zbatimin e katër parimeve të identifikuar në Kodin e praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes, përkatësisht pjesëmarrjen, besimin, llogaridhënien dhe pavarësinë;
- b.** organizojnë kurse trajnimi në administratat e tyre për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e transparencës, dhe në veçanti:
 - i.** organizojnë aktivitete edukative në institucionet publike, të tilla si seminare, punëtori dhe ngjarje tra-

- jnimi në vend pune për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet nga qeveria e hapur dhe rëndësia e transparencës;
- ii.** rrisin përdorimin e të dhënave të hapura dhe menaxhimin e regjistrave nga administratat e tyre, ndërsa sigurohen që t'i publikojnë këto në mënyra gjithëpërfshirëse, të arritshme dhe të ripërdorshme;
- c.** promovojnë përfshirjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike lokale, duke:
- i.** zbatuar masa për të ndihmuar qytetarët të kuptojnë më mirë punën e qeverive të tyre në mënyrë që të sigurojnë besimin e publikut;
 - ii.** inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në politikat e tyre dhe proceset e vendimmarrjes, duke marrë parasysh rëndësinë dhe relevancën që shoqëria civile, përfshirë OJQ-të dhe sinjalizuesit, mund të kenë në procesin e vendimmarrjes;
 - iii.** rritur përdorimin e më shumë formave të ndryshme të angazhimit publik diskutues, të tilla si konsultimet publike, për të informuar proceset e tyre të politikë-bërjes dhe vendim-marrjes;
 - iv.** promovuar përfshirjen e qytetarëve në përcaktimin e prioritetëve buxhetore dhe vlerësimin e kontratave të rëndësishme, të tilla si ato që lidhen me projektet e mëdha infrastrukturore;
 - v.** mundësuar qytetarëve të marrin pjesë në seancat e këshillit të qytetit dhe parlamentit rajonal dhe të përcaktojnë kritere që rregullojnë pjesëmarrjen e tyre në takime të tilla;
 - vi.** promovuar mbledhjen e informatave kthyesë për kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet pub-

- like, pavarësisht nëse ato menaxhohen drejtpërdrejt ose tërthorazi nga autoritetet lokale dhe rajonale;
- vii.** reaguaro ndaj ankesave dhe rekomandimeve nga qytetarët, në mënyrë që të rritet besimi i publikut në qeverisjen lokale dhe rajonale;
 - d.** kryejnë hulumtime dhe konsultime me palë të ndryshme të komuniteteve, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, sindikatat dhe zyrtarët e burimeve njerëzore, në mënyrë që të hartojnë politika më të përshtatshme për nevojat lokale;
 - e.** inkurajojnë auditime të brendshme, të jashtme dhe sociale të administratave të tyre;
 - f.** sigurojnë që masat në lidhje me transparencën dhe qeveritë e hapura nuk shkelin ligjet e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë.
7. Përfshihet vetë në:
- a.** zhvillimin dhe promovimin e standardeve ndërkombëtare të qeverisë së hapur të zbatueshme për qeveritë lokale dhe rajonale;
 - b.** sigurimin e asistencës teknike për qeveritë lokale dhe rajonale për të zbatuar mekanizmat e qeverisë së hapur;
 - c.** mbështetjen e shkëmbimit mes kolegëve dhe të të mësuarit midis qeverive lokale dhe rajonale duke iniciuar reformat e qeverisë së hapur;
 - d.** inkurajimin e anëtarësimit në partneritetin për qeveri të hapur.

REKOMANDIMI 424 (2018)³

1. Në sesionin e tij të 31^{-të} në tetor 2016, Kongresi miratoi një udhërrëfyes të aktiviteteve duke përfshirë gjashtë raporte tematike për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e qeverisjes së mirë si në nivelin lokal ashtu edhe në atë rajonal. Ky udhërrëfyes përfshiu një raport mbi transparencën dhe qeverinë e hapur si pjesë e punës për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivelet lokale dhe rajonale.

2. Qeveria e hapur përshkruan një qeveri që është transparente, pjesëmarrëse dhe llogaridhënëse ndaj qytetarëve të vet. Ky është një koncept që mund të zbatohet për çdo qeveri, pavarësisht nga madhësia e saj dhe pa marrë parasysh nëse është lokale, rajonale apo kombëtare. Shumë autoritete lokale dhe rajonale kanë zbatuar tashmë reforma të qeverisë së hapur, jo vetëm për të rritur transparencën e tyre në lidhje me qytetarët, por edhe për të rritur efikasitetin e tyre.

3. Një qeveri e hapur është qeveri, puna e së cilës mund të kuptohet nga publiku. Kjo do të thotë që qytetarët duhet të jenë në gjendje të shohin ato që qeveria e tyre ka diskutuar dhe krijuar, dhe të kërkojnë informacion nga administrata e tyre lokale. Nga ana e tyre, administratat dhe autoritetet ter-

³ Shih fusnotën 2

ritoriale duhet të lehtësojnë qasjen në informacionin e tyre, për ta bërë informacionin të disponueshëm duke përdorur sisteme për të dhëna të hapura dhe për të vendosur politika dhe procedura të forta të menaxhimit të regjistrave.

4. Një qeveri e hapur duhet edhe ta rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve si në punimet e qeverive të tyre ashtu edhe në hapësirën qytetare. Për të inkurajuar përfshirjen e tillë të publikut me autoritetet dhe OJQ-të, qeveritë duhet të parandalojnë kufizime të padrejta ose pasoja të mundshme të aktiviteteve të tilla. Këto masa mbrojtëse duhet të shtrihen edhe tek sinjalizuesit.

5. Së bashku me transparencën dhe pjesëmarrjen, llogaridhënia është tipari i tretë thelbësor i një qeverie të hapur. Ky është një tipar thelbësor i demokracisë që publiku duhet të jetë në gjendje ta mbajë qeverinë e tij përgjegjëse për veprimet e saj. Llogaridhënia mund të inkurajohet me mjete të brendshme, të tilla si kodet e etikës, ose ato të jashtme, duke përfshirë auditimet, dhe vëzhgimet nga shoqëria civile dhe media.

6. Këto tri parime të qeverisë së hapur - transparenca, pjesëmarrja dhe llogaridhënia - mund dhe duhet të zbatohen në pesë funksionet kryesore të qeverisë territoriale: buxhetimi, kontraktimi, ligj-bërja, politikë-bërja dhe ofrimi i shërbimeve.

7. Në dritën e konsideratave të mësipërme, Kongresi:

a. duke pasur parasysh:

i. Rezolutën 417 të Kongresit dhe Rekomandimin 398 (2017) mbi të dhënat e hapura për shërbime më të mira publike;

- ii.** Rezolutën 421 të Kongresit dhe Rekomandimin 405 (2017) mbi Bërjen transparente të prokurimit publik në nivelet lokale dhe rajonale;
 - iii.** “Udhëzimet për pjesëmarrjen civile në vendimmarrjen politike” (2017) të Këshillit të Evropës;
 - iv.** 12 parimet e qeverisjes së mirë (2008) të Këshillit të Evropës;
 - v.** Doracakun e Këshillit të Evropës për Etikën Publike në Nivelin Lokal (2004);
 - vi.** Kodin e praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes (2009, Konferenca e OJQ-ve e Këshillit të Evropës);
 - vii.** Rekomandimin e OBZHE-së të Këshillit për Qeverinë e Hapur (2017)
 - viii.** Kartën Ndërkombëtare të të Dhënave të Hapura (2015), të miratuar në Samitin global të partneritetit për qeveri të hapur;
- b.** duke njohur që qeverisja e hapur ka potencial të madh për përmirësimin e demokracisë në nivelin lokal dhe rajonal;
 - c.** i vetëdijshëm se qeveria lokale më e hapur mund të rrisë besimin e publikut dhe të ulë korrupsionin, të dyja këto janë të nevojshme në mënyrë që demokracia lokale të lulëzojë;
 - d.** i vetëdijshëm se zbatimi i parimeve të qeverisë së hapur mund të çojë në ofrim më efektiv të shërbimeve publike lokale;
 - e.** i bindur se shtetet anëtare të Këshillit të Evropës duhet të bëjnë më shumë për të promovuar qeverisjen e hapur në çdo nivel;

8. Rekomandon që Komiteti i Ministrave t'iu bëjë thirrje qeverive të shteteve të tyre anëtare që të:

a. miratojnë standarde të përbashkëta për qeveri të hapur, në veçanti duke:

i. u nisur nga gjashtë parimet e Kartës Ndërkombëtare të të Dhënave të Hapura;

ii. mbështetur miratimin e standardeve të përbashkëta të qeverisë së hapur, të tilla si Parimet Globale të Kontraktimit të Hapur;

iii. mbështetur zbatimin e katër parimeve të identifikuar në Kodin e praktikës së mirë për pjesëmarrjen civile në procesin e vendimmarrjes, përkatësisht pjesëmarrjen, besimin, llogaridhënien dhe pavarësinë, siç është e nevojshme për të siguruar bashkëpunim të mirë midis shoqërisë civile dhe qeverive;

b. inkurajojnë autoritetet territoriale të publikojnë dokumente dhe informacione kryesore, dhe në veçanti:

i. të inkurajojnë publikimin e dokumenteve buxhetore;

ii. informacione në lidhje me nivelet e shërbimit publik që njerëzit kanë të drejtë;

iii. të lehtësojnë qasjen në të dhëna që janë të kuptueshme, për t'u përdorur nga sektori publik dhe privat;

iv. të promovojnë publikimin e dokumenteve kryesore në shumë gjuhë;

c. mbështesin proceset e konsultimit publik;

d. mbështesin monitorimin dhe zbatimin efektiv të masave të transparencës në nivelin lokal dhe rajonal, veçanërisht duke:

- i.** siguruar që Zyrat e Avokatit të Popullit luajnë rol aktiv në zbatimin e qeverisë së hapur;
 - ii.** siguruar auditime të rregullta të brendshme dhe/ose të jashtme të autoriteteve lokale;
 - iii.** lehtësuar kryerjen e auditimeve sociale nga OJQ-të në nivelin lokal;
- e.** përfshijnë të gjitha palët e interesit në promovimin e transparencës dhe qeverisë së hapur në nivelet lokale dhe rajonale, dhe në veçanti:
- i.** të inkurajojnë edukim më të madh buxhetor të parlamentarëve, zyrtarëve qeveritarë, përfaqësuesve të zgjedhur, gazetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile;
 - ii.** të ndërgjegjësojnë publikun për rëndësinë e shoqërisë civile, OJQ-ve dhe sinjalizuesve në trajtimin e problemeve të korrupsionit dhe keqpërdorimeve në qeverinë lokale dhe rajonale;
- f.** sigurojnë që legjislacioni i tyre është në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rekomandim dhe me memorandumun e tij shpjegues.

MEMORANDUM SHPJEGUES4

4 Raportuesi dëshiron të falënderojë shoqatën INVOLVE për kontributin e saj në këtë raport.

1. Hyrje

1. Qeveria e hapur është ideja e thjeshtë por e fuqishme që qeveritë do të punojnë më mirë për njerëzit nëse ato janë transparente, pjesëmarrëse dhe llogaridhënëse.

2. Nga buxhetimi me pjesëmarrje në Porto Alegre tek buxhetimi me pjesëmarrje në Paris, qeveritë lokale në të gjithë botën kanë qenë prej kohësh pionierë të qeverisë së hapur. Ky raport prezanton konceptin e qeverisë së hapur dhe implikimet e tij për qeveri lokale. Ai jep rekomandime për mënyrën se si qeveritë lokale, veçanërisht në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, mund të miratojnë parime dhe praktika për qeveri të hapur, dhe atë që Këshilli i Evropës mund të bëjë për të siguruar mbështetje.

1.1 Përcaktimi i Qeverisë së Hapur

3. Përkufizimet e përbashkëta të qeverisë së hapur kanë tendencë të përfshijnë tri parime kryesore: transparencja, pjesëmarrja dhe llogaridhënia. Tabela më poshtë përmbledh atë se çfarë nënkuptojnë këto nga këndvështrimi i qytetarëve dhe qeverive.

Parimi	Çfarë do të thotë për qytetarët	Çfarë do të thotë për qeveritë
Transparenca	Publiku mund të shohë dhe kuptojë punimet e qeverisë së tij	Hapja e të dhënave dhe informacioneve qeveritare për fusha të tilla si shpenzimet publike, kontratat qeveritare, aktiviteti i lobimit, zhvillimi dhe ndikimi i politikës dhe performanca e shërbimeve publike.
Pjesëmarrja	Publiku mund të ndikojë në punimet e qeverisë së tij	Mbështetja për një shoqëri civile të fortë dhe të pavarur, përfshirja e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit në proceset e vendimmarrjes, dhe mbrojtja për sinjalizuesit dhe të tjerët që nxjerrin në pah keqpërdorimet, neglizhencën ose korrupsionin në qeveri.
Llogaridhënia	Publiku mund të kërkojë llogari nga qeveria e tij për veprimet e saj	Vendosja e rregullave, ligjeve dhe mekanizmave që sigurojnë që qeveria dëgjon, mëson, përgjigjet dhe ndryshon kur ka nevojë.

4. Qeveria e hapur është një term ombrellë për një gamë të gjerë praktikash që i çojnë më tej këto parime, përfshirë iniciativat për të dhëna të hapura, qasjen në ligjet e informacionit, të drejtat politike, mbrojtjet e sinjalizuesve, konsultimet publike dhe proceset e angazhimit, ndër shumë të tjera.

5. Koncepti i qeverisë së hapur shpesh shtrihet edhe për të përfshirë iniciativa që synojnë institucione të tjera të fuqishme (p.sh. biznesi, parlamenti, sistemet ligjore, etj.). Prandaj shpesh është më e përshtatshme të konsiderohet koncepti si qeverisje e hapur ose shtet i hapur, sesa qeveri e hapur.

1.2 Histori e shkurtër e qeverisë së hapur

6. Origjinat moderne të qeverisë së hapur shpesh datojnë në mendimin e iluminizmit, e cila përfshinte elemente domethënëse të mendimit rreth lirisë së shtypit dhe qasjes në informacion.

7. Pjesa e parë e legjislacionit të qeverisë së hapur i kreditohet Suedisë, e cila aplikoi e para ligjin për qasjen në informacion. Akti i Lirisë së Shtypit, i cili u miratua në vitin 1766 dhe që është pjesë e Kushtetutës suedeze, i dha publikut qasje në çdo dokument zyrtar përveç nëse ato përmbajnë informacion të përcaktuar si sekret. Mbi 100 ligje për qasjen në informacion janë aplikuar që nga atëherë në tërë botën, megjithëse u desh deri në vitin 1966 që të bëhej i dyti dhe shumica janë bërë që nga viti 2000.⁵

8. Gjysma e dytë e shekullit të njëzetë gjithashtu pa zhvillimin e ligjeve dhe praktikave të rëndësishme, ndër të tjera, në të drejtat e njeriut, konsultimin publik, llogaridhënien sociale dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Vitet e fundit kanë parë një momentum të ripërtërirë të qeverisë së hapur, të mbështetur veçanërisht nga zhvillimet në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), paraqitja e lëvizjes së të dhënave të hapura dhe kampionëve të profilit të lartë politik si Presidenti Obama.

9. Një shkak dhe efekt i këtij momentumit të ripërtërirë ka qenë krijimi i Partneritetit global të Qeverisë së Hapur (PQH). PQH-ja, e cila filloi me anëtarësimin e tetë qeverive, u lansua

⁵ Freedominfo.org (n.d.) Regjimet e FOI-së (Lirisë së informacionit) <http://www.freedominfo.org/regions/global/foi-regimes/>

në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së në shtator 2011 si 'iniciativë ndërkombëtare vullnetare, me shumë aktorë që synon të sigurojë angazhime konkrete nga qeveritë ndaj qytetarisë së tyre për të promovuar transparencën, fuqizuar qytetarët, luftuar korrupsionin dhe shfrytëzuar teknologjitë e reja për të forcuar qeverisjen'.⁶

10. Që nga fillimi i saj, PQH-ja ka krijuar një anëtarësim të mbi 70 qeverive kombëtare, të cilat kanë zhvilluar më shumë se 200 plane veprimi që përmbajnë mbi 2,500 angazhime. PQH-ja ishte ekskluzivisht një partneritet i shteteve anëtare deri në vitin 2016, kur prezantoi një program pilot nënkombëtar me katërmbëdhjetë qeveri nënkombëtare (përfshirë nivelet e qeverive të transferuara, rajonale dhe lokale). Qeveritë nënkombëtare nënshkruan Deklaratën Nënkombëtare të Qeverisë së Hapur në Paris në dhjetor 2016 (shih Kutinë 1).

⁶ Pikat e qeverisjes së partneritetit për qeveri të hapur (2012), qershor 2012 [Përditësuar në mars 2014 dhe prill 2015] https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/attachments/OGP%2520ArticlesGov%2520Apr%252021%25202015_0%5B1%5D.pdf

KUTIA 1: Deklarata Nënkombëtare e Qeverisë së Hapur, Paris - Francë 2016 ⁷

Ne, qeveritë e transferuara, lokale, rajonale dhe nënkombëtare nga e gjithë bota, që përfaqësojnë popullatat e komunave, qyteteve, zonave metropolitane, qarqeve, shteteve, provincave, rajoneve dhe vendeve, jemi mbledhur në Samitin global të partneritetit për qeveri të hapur, të thirrur nga Qeveria e Francës, Partneriteti për Qeveri të Hapur dhe Qyteti i Parisit, për të:

Pranuar:

1. Se qeveria është më e afërta me njerëzit në nivelin nënkombëtar, duke ofruar mundësi më të mëdha për ndryshime vërtet transformuese në një qeveri më transparente, më të përgjegjshme, më llogaridhënëse, dhe më efektive për të përfituar të gjithë qytetarët.
2. 15 qeveritë e transferuara, lokale, rajonale dhe nënkombëtare, të cilat e përbëjnë Programin Pilot Nën-kombëtar Pioner të PQH-së, duke punuar për të avancuar qeverinë lokale të hapur.
3. Rolin e spikatur të shoqërisë civile në bashkë-krijimin e planeve të veprimit nënkombëtar, dhe zbatimin e këtyre angazhimeve drejt ndryshimit transformues për qytetarët në nivelin lokal.
4. Rëndësinë e mbështetjes së qeverisë së nivelit shtetëror dhe agjendën globale të qeverisë së hapur.

⁷ http://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/OGP_subnational-declaration_EN.pdf

Angazhuar në:

1. Misionin e PQH-së për të “kultivuar një kulturë globale të qeverisës së hapur që i fuqizon dhe u shërben qytetarëve dhe i shtyn përpara idealet e qeverisë së hapur dhe pjesëmarrëse të shekullit 21”.
2. Deklaratën e Qeverisë së Hapur, e cila na inkurajon që: të rrisim disponueshmërinë e informacionit në lidhje me aktivitetet qeveritare, të mbështesim pjesëmarrjen qytetare, të zbatojmë standardet më të larta të integritetit profesional në të gjitha administratat tona dhe të rrisim qasjen në teknologji të reja për hapjen dhe llogaridhënien.
3. Krijimin dhe zbatimin e angazhimeve për qeveri të hapur së bashku me partnerët e shoqërisë civile të cilët i çojnë përpara nevojat e komunitetit lokal.

Bërë thirrje:

1. Shtesë qeverive të transferuara, lokale, rajonale dhe nënkombëtare dhe partnerëve të shoqërisë civile për të nënshkruar këtë deklaratë dhe për të ndjekur qeverinë lokale të hapur.
2. Komunitetit të PQH-së të njohë rolin e rëndësishëm të qeverive të transferuara, lokale, rajonale dhe nënkombëtare në partneritet.
3. Vendeve të PQH-së të angazhohen dhe të mbështesin rolin e qeverive nënkombëtare përmes planeve lokale të veprimit si dhe përfshirjes së perspektivës dhe angazhimeve nënkombëtare në Planet Kombëtare të Veprimit.

1.3 Arsyet për qeveri të hapur

11. Reformat për qeveri të hapur janë zbatuar në ndjekje të një sërë objektivash. Reformat më të suksesshme janë ato që adresojnë një problem të qartë dhe kanë një teori të zhvilluar mirë të ndryshimit. Disa nga objektivat më të zakonshme të reformave të qeverisë së hapur janë ndjekja e qeverisjes së mirë, vendimmarrja më e mirë, besimi më i madh i publikut, korrupsioni i reduktuar dhe shërbimet më efektive publike.

1.3.1 Qeverisja e mirë

12. Hapja dhe llogaridhënia gjithnjë e më shumë njihen si cilësi themelore të qeverisjes së mirë demokratike. Për shembull, 12 parimet e Këshillit të Evropës për qeverisjen e mirë, të përfshira në 'Strategjinë Evropiane për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal', identifikojnë parimet e qeverisë së hapur si thelbësore për qeverisjen e mirë demokratike (shih Kutinë 2).

KUTIA 2: 12 parimet e qeverisjes⁸ së mirë

- 1. Sjellja e Drejtë në Zgjedhje, Përfaqësim dhe Pjesëmarrje**, për të siguruar mundësi reale për të gjithë qytetarët për të thënë fjalën e tyre për punët publike lokale;
- 2. Përgjegjësia**, për të siguruar që autoriteti lokal i përmbush pritjet legjitime dhe nevojat e qytetarëve;
- 3. Efikasiteti dhe Efektiviteti**, për të siguruar përmbushjen e objektivave gjatë përdorimit më të mirë të burimeve;

⁸ Strategjia e Këshillit të Evropës (2007) për Inovacion dhe Qeverisje të Mirë në Nivel Lokal - <https://rm.coe.int/1680701699>

4. **Hapja dhe Transparenca**, për të siguruar qasjen e publikut në informacion dhe për të lehtësuar të kuptuarit se si kryhen punët publike lokale;
5. **Sundimi i Ligjit**, për të siguruar drejtësi, paanshmëri dhe parashikueshmëri;
6. **Sjellja Etike**, për të siguruar që interesi publik të vihet para atyre private;
7. **Kompetenca dhe Kapaciteti**, për të siguruar që përfaqësuesit dhe zyrtarët lokalë janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre;
8. **Inovacioni dhe Hapja për Ndryshim**, për të siguruar që përfitimi buron nga zgjidhjet e reja dhe praktikatat e mira;
9. **Qëndrueshmëria dhe Orientimi Afatgjatë**, për të marrë parasysh interesat e brezave të ardhshëm;
10. **Menaxhimi i Shëndoshë Financiar**, për të siguruar përdorimin e kujdesshëm dhe produktiv të fondeve publike;
11. **Të drejtat e njeriut**, Diversiteti kulturor dhe Kohezioni social, për të siguruar që të gjithë qytetarët të mbrohen dhe respektohen dhe se askush nuk diskriminohet ose përjashtohet;
12. **Logaridhënia**, për të siguruar që përfaqësuesit dhe zyrtarët lokalë marrin përgjegjësi dhe mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre.

13. Prandaj, reformat për qeveri të hapur shpesh konsiderohen se kanë vlerë të brendshme përmes avancimit të këtyre parimeve të qeverisjes së mirë demokratike.

1.3.2 Vendimmarrje më e mirë

14. E lidhur, por e dallueshme nga, vlera e brendshme e qeverisë së hapur për qeverisje të mirë është vlera e saj instrumentale për vendimmarrje më të mirë. Qeveria e hapur shpesh konsiderohet të promovojë vendimmarrje më të mirë në qeveri. Nga njëra anë, kjo shpesh bazohet në idenë që hapja frenon tejkalimet më të këqija të pushtetit dhe inkurajon vendimmarrje më të përgjegjshme dhe më të drejtë përmes frikës se mos kapeni. Kjo lidhet me objektivin e zvogëlimit të korrupsionit.

15. Nga ana tjetër, vlera që qytetarët dhe palët e tjera të interesit duhet t'i ofrojnë vendimmarrjes - në formën e përvojës personale, ideve, ekspertizës dhe shqyrtimit - po njihet gjithnjë e më shumë. Kjo mbështetet nga hulumtimi që tregon se grupe më të mëdha dhe më të larmishme të njerëzve zakonisht marrin vendime më të mira sesa grupet më të vogla dhe homogjene.⁹

1.3.3 Besim më i madh publik

16. Rritja e hapjes shpesh është avancuar si zgjidhje për krizën e besimit të publikut në institucionet publike, e cila po përjetohet në të gjithë botën. Në praktikë, marrëdhënia reale midis qeverisë së hapur dhe besimit është e ndërlikuar. Pjesëmar-

⁹ Surowiecki, J. (2004) *Mençuria e Turmave: Sepse shumë janë më të zgjuar sesa pak*. Londër: Abacus

rja e publikut, aty ku bëhet mirë, mund të ndihmojë në krijimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve. Ndërsa njerëzit mund të kenë perceptime përgjithësisht negative për një institucion amorf, ballafaqimi me vendimmarrësit mund të ndihmojë në krijimin e besimit, veçanërisht kur ndihen të dëgjuar dhe të vlerësuar.

17. Nga ana tjetër, transparenca ka treguar se ka potencialin për të ulur besimin e publikut, pasi zbulon korrupsionin, vendimmarrjen e keqe dhe dështimet e tjera në qeveri. Sidoqoftë, rritja e besueshmërisë në qeveri është një pararendës i rëndësishëm për rritjen e besimit të publikut, dhe transparenca mund të jetë një mekanizëm i dobishëm për arritjen e kësaj.

1.3.4 Korrupsion i zvogëluar

18. Drita e diellit shpesh thuhet se është dezinfektuesi më i mirë për korrupsionin dhe qëllimi specifik i shumë iniciativave për qeveri të hapura është ulja e korrupsionit në institucione. Hapja mendohet të ketë efekt rregullues në sjelljen e zyrtarëve publikë nëse ata mendojnë se janë nën vëzhgim të publikut, medias, shoqërisë civile ose rojtarëve publikë. Sidoqoftë, transparenca do të zvogëlojë korrupsionin vetëm nëse mbështetet nga mekanizmat efektivë të llogaridhënies që vendosin sanksione ndaj të korruptuarve. Pa praninë e mekanizmave të tillë, ekspozimi i korrupsionit shërben vetëm për të zvogëluar besimin e publikut dhe për të shkurajuar sinjalizuesit për të raportuar raste të tilla.

19. Siç u tha më sipër, aty ku ekziston një sistem gjithëpërfshirës dhe efektiv i standardeve, zbulimit, raportimit, hetimit

dhe sanksionimit, qeveria e hapur mund të ndihmojë në uljen e konsiderueshme të korrupsionit.

1.3.5 Shërbime më efektive

20. Së fundmi, qeveria e hapur shpesh propozohet edhe si mekanizëm për përmirësimin e shërbimeve publike. Kjo bazohet në idenë që shërbimet publike që janë më të përgjegjshme dhe më llogaridhënese për njerëzit - dhe përfitojnë nga njohuritë, idetë, energjia dhe shqyrtimi i tyre - do të funksionojnë më mirë për njerëzit.¹⁰

21. Ekzistojnë një sërë shembujsh nga e gjithë bota që demonstrojnë se qeveria e hapur mund të jetë efektive në përmirësimin e cilësisë dhe qasshmërisë së shërbimeve publike për qytetarët. Sidoqoftë, marrëdhënia midis qeverisë së hapur dhe shërbimeve më efektive nuk është e thjeshtë dhe varet nga një sërë faktorësh kontekstualë (p.sh. hapësira qytetare, kapaciteti shtetëror dhe media e pavarur), dizajni i mirë (p.sh. një problem i qartë dhe përsëritja me kalimin e kohës), dhe një teori e qartë ndryshimi. Specifikisht, reformat e suksesshme zakonisht kërkojnë lidhje të qartë nga transparenca (p.sh. qasja në informacion dhe të dhëna të hapura), përmes pjesëmarrjes, tek llogaridhënia (p.sh. stimuj, sanksione dhe informata kthyesë).

¹⁰ Hughes, T; Scott, K; & Maassen, P. (2017) Përmirësimi i Shërbimeve Publike: Udhëzime për zhvillimin e angazhimeve të PQH-së. Uashington DC: Partneriteti për qeveri të hapur. https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/OGP_public-service-guidance.pdf

2. Elemente përshkuese të qeverisë së hapur

22. Ekzistojnë një numër elementësh themelorë të qeverisë së hapur nën titujt e transparencës, pjesëmarrjes dhe llogaridhënies që përshkojnë të gjitha funksionet e qeverisë dhe fushat e politikave. Më poshtë janë prezantime të shkurtra për secilin, me vegëza që çojnë në materiale dhe udhëzime të mëtejme.

Transparenca	Pjesëmarrja	Llogaridhënia
1. Qasja në informacion 2. Të dhëna të hapura 3. Menaxhimi i regjistrave	1. Hapësira qytetare 2. Pjesëmarrja qytetare 3. Mbrojtjet e sinjalizuesve	1. Auditimi 2. Kodi i Etikës 3. Shqyrtimi

2.1 Transparenca - “Publiku mund të ndikojë në punimet e qeverisë së tij”

2.1.1 Qasja në informacion

23. Qasja në informacion - e njohur ndryshe si e drejta në informacion ose liria e informacionit - është një bllok përbërës ndërtimi i qeverisë së hapur. Ajo siguron të drejtën ligjore që qytetarët të kërkojnë informacion nga qeveria, e cila duhet të sigurohet përveç nëse i përshtatet një përjashtimi specifik në ligj.

24. Që nga shtatori 2016, 113 vende ose territore kishin qasje në dispozitat e informacionit në ligjet e tyre kombëtare

ose federale, ose dekretet për veprim.¹¹ Përveç ligjeve kombëtare, e drejta në informacion është njohur në deklaratat ndërkombëtare, përfshirë pikën 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, dhe nga gjykata ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

25. Konventa e Këshillit të Evropës për Qasjen në Dokumentet Zyrtare përshkruan një numër standardesh për të qeverisur të drejtën për qasje në dokumente zyrtare, duke përfshirë përjashtimet, proceset për kërkesë, procedurat për tarifim dhe shqyrtim.¹²

2.1.2 Të dhëna të hapura

26. Të dhënat e hapura janë shtesa relativisht të kohëve të fundit për qeveri të hapur, të mundësuar përmes përmirësimeve në TIK që mundësojnë sasi të mëdha të të dhënave të mblidhen, publikohen dhe merren me lehtësi relative. Sipas Open Definition, 'të dhënat dhe përmbajtja e hapur mund të përdoren, modifikohen dhe ndahen lirisht nga çdokush për çfarëdo qëllimi'.¹³ Këto tri cilësi të përdorimit falas, ripërdorimit dhe publikimit janë thelbësore që të dhënat të konsiderohen të hapura.

27. Në vitin 2015, Karta Ndërkombëtare e të Dhënave të Hapura u lansua duke përvijuar gjashtë parime për lëshimin e të dhënave:

11 Iniciativa për Drejtësi për Shoqëri të Hapur <http://www.right2info.org/resources/publications/countrieswithaprovisions113Sept2016.pdf>

12 Këshilli i Evropës (2009) Konventa e Këshillit të Evropës për Qasje në Dokumente Zyrtare; Seria e Traktatit të Këshillit të Evropës - Nr. 205, <https://rm.coe.int/1680084826>

13 <http://opendefinition.org>

1. Të hapura me parazgjedhje (by Default);
2. Me kohë dhe gjithëpërfshirëse;
3. Të qasshme dhe të përdorshme;
4. Të krahasueshme dhe të ndërveprueshme;
5. Për Qeverisje të Përmirësuar dhe Angazhim të Qytetarëve; dhe
6. Për Zhvillim Gjithëpërfshirës dhe Inovacion.

28. Në kohën e shkrimit, Karta është miratuar nga 47 qeveri, përfshirë 17 qeveri kombëtare dhe 30 lokale/nënkombëtare.¹⁴

2.1.3 Menaxhimi i regjistrave

29. Menaxhimi i mirë i regjistrave siguron që informacioni është i qasshëm, gjithëpërfshirës dhe i besueshëm, dhe për këtë arsye mbështet qasjen në informacion dhe në të dhëna të hapura. Siç e përshkruan Open Government Guide (Udhëzuesi për Qeveri të Hapur), 'menaxhimi i regjistrave nuk do të arrijë vetë hapjen, por pa të, hapja nuk është e mundur.'¹⁵

30. Procedurat e menaxhimit të mirë të regjistrave sigurojnë që informacioni është autentik dhe i besueshëm, mund të merret shpejt dhe lehtë, ruhet për një kohë të duhur, hidhet në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme dhe mbrohet në mënyrë të përshtatshme nëse është private ose konfidenciale.

¹⁴ Karta Ndërkombëtare e të Dhënave të Hapura; <http://opendatacharter.net>

¹⁵ Open Government Guide (n.d.) Menaxhimi i regjistrave <http://www.opengovguide.com/topics/records-management/>

2.2 Pjesëmarrja - “Publiku mund të ndikojë në punimet e qeverisë së tij”

2.2.1 Hapësira qytetare

31. Mekanizmat e qeverisë së hapur shpesh bazohen në supozimin se qytetarët dhe shoqëria civile do të kërkojnë dhe qasen në informacione, dhe t’i përdorin ato për të kërkuar llogari nga vendimmarrësit. Kjo është e mundur vetëm kur shoqëria civile është e lirë nga kufizimet dhe nuk kanë frikë nga pasojat e mundshme.¹⁶ Hapësira qytetare përcaktohet si ‘liria dhe mjetet [për individët dhe grupet e organizuara] për të folur, për t’u qasur në informacion, për t’u shoqëruar, për të organizuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrjen publike’¹⁷ dhe është parakusht thelbësor për qeveri të hapur.

32. Këshilli i Evropës identifikon katër parime të kërkuara për të kultivuar marrëdhënie konstruktive midis shoqërisë civile dhe qeverive:¹⁸

1. Pjesëmarrja: OJQ-të mbledhin dhe kanalizojnë pikëpamjet e qytetarëve. Ky është një kontribut i vlefshëm në procesin e vendimmarrjes politike, duke rritur cilësinë, kuptueshmërinë dhe zbatueshmërinë afatgjate të iniciativës së politikës.

16 Fox, J. (2014) Llogaridhënia sociale: Çfarë thonë vërtet provat? Dokument Punues i PGLLS-së, nr.1, Uashington DC: Partneriteti global për llogaridhënie sociale/Banka Botërore <http://gpsaknowledge.org/wp-content/uploads/2015/04/Social-Accountability-What-Does-Evidence-Really-Say-GPSA-Working-Paper-1-with-Foreword.pdf>

17 Malena, C. (2015) Përmirësimi i matjes së hapësirës civile. Londër: Nismë për Transparencë dhe Llogaridhënie. <http://www.transparency-initiative.org/archive/wp-content/uploads/2015/05/TAI-Civic-Space-Study-v13-FINAL.pdf>

18 Këshilli i Evropës (2009) Pjesëmarrja Civile në Procesin e Vendimmarrjes: Kodi i Praktikës së Mirë. Strasburg: Këshilli i Evropës. <https://rm.coe.int/16802eede1>

2. Besimi: Një shoqëri e hapur dhe demokratike bazohet në ndërveprimin e ndershëm midis aktorëve dhe sektorëve. Megjithëse OJQ-të dhe autoritetet publike kanë role të ndryshme për të luajtur, qëllimi i përbashkët për të përmirësuar jetën e njerëzve mund të arrihet në mënyrë të kënaqshme vetëm nëse bazohet në besim, duke nënkuptuar transparencën, respektin dhe besueshmërinë e ndërsjellë.
3. Llogaridhënia dhe transparenca: Të veprosh në interes të publikut kërkon hapje, përgjegjësi, qartësi dhe llogaridhënie nga OJQ-të dhe autoritetet publike, me transparencë në të gjitha fazat.
4. Pavarësia: OJQ-të duhet të njihen si organe të lira dhe të pavarura në lidhje me qëllimet, vendimet dhe aktivitetet e tyre. Ata kanë të drejtë të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të mbrojnë pozicione të ndryshme nga autoritetet me të cilat ata edhe mund të bashkëpunojnë.

2.2.2 Angazhimi qytetar

33. Angazhimi qytetar - i njohur ndryshe si pjesëmarrja e publikut, përfshirja e qytetarëve dhe kombinimet e tyre - i referohet vendit ku qeveria angazhohet në mënyrë proaktive me qytetarët, shoqërinë civile dhe grupe të tjera të palëve të interesit.

34. Angazhimi qytetar mund të bëhet në çdo fazë të ciklit të politikave, nga identifikimi i prioriteteve, përmes informimit dhe marrjes së vendimeve, deri në zbatimin dhe vlerësimin e politikës. Ai gjithashtu mund të zhvillohet në nivele të ndryshme, nga procese të tilla si konsultimet publike, ku palët e interesit informojnë një proces vendimmarrjeje, deri tek pro-

ceset e tilla si buxhetimi me pjesëmarrje, ku qytetarët e marrin vetë vendimin përfundimtar. Shoqata Ndërkombëtare për Pjesëmarrje Publike (IAP2) identifikon 5 nivele të pjesëmarrjes:

- ▶ Informimi: siguron publikun me informacion të ekuilibruar dhe objektiv për t'i ndihmuar ata që të kuptojnë problemin, alternativat, mundësitë dhe/ose zgjidhjet;
- ▶ Konsultimi: marrja e informatave kthyesë nga publiku për analizat, alternativat dhe/ose vendimet;
- ▶ Përfshirja: puna e drejtpërdrejtë me publikun gjatë gjithë procesit për të siguruar që shqetësimet dhe aspiratat e publikut të kuptohen dhe konsiderohen vazhdimisht;
- ▶ Bashkëpunimi: partneriteti me publikun në secilin aspekt të vendimit, përfshirë zhvillimin e alternativave dhe identifikimin e zgjidhjes së preferuar;
- ▶ Fuqizimi: vendosja e vendimmarrjes përfundimtare në duart e publikut.

2.2.3 Mbrojtja e sinjalizuesve

35. Punonjësit janë shpesh njerëzit e parë që i vërejnë sjelljet korruptive, të rrezikshme, të pandershme dhe/ose të paligjshme brenda një organizate. Sinjalizuesit, pra, luajnë rol kritik në qeveri të hapur, duke alarmuar organizatat dhe shoqërinë e gjerë për keqbërje atje ku paraqitet. Organizatat përgjegjëse krijojnë procedura dhe mbrojtje të qarta të sinjalizimit, që sigurojnë se individët mund të raportojnë shqetësimet e tyre me siguri se ato do të adresohen në mënyrë të përshtatshme dhe pa frikë për pasojat negative për sigurinë ose karrierën e tyre.

36. Rezoluta 1729 e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të

Evropës 'njeh rëndësinë e sinjalizuesve - individë të shqetësuar të cilët japin alarmin për të ndaluar keqberjet që vendosin qeniet njerëzore në rrezik - pasi veprimet e tyre ofrojnë një mundësi për të forcuar llogaridhënien dhe për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe keqmenaxhimit, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat.¹⁹

2.3 Llogaridhënia - "Publiku mund të kërkojë llogari nga qeveria e tij për veprimet e saj"

2.3.1 Auditimi

37. Auditimi, i brendshëm dhe i jashtëm, është thelbësor për të siguruar që paratë publike të mblidhen, menaxhohen dhe shpenzohen në mënyrë të duhur nga qeveria lokale. Doracaku i Këshillit të Evropës për Etikën Publike në Nivelin Lokal potencon se:²⁰

'Mekanizmat e auditimit dhe kontrollit të autoriteteve lokale duhet të pasqyrojnë angazhim ndaj sundimit të ligjit, transparencës, pjesëmarrjes demokratike dhe kontrollit efektiv të brendshëm dhe të jashtëm të zyrtarëve të zgjedhur lokalë. [...]

Një kornizë për shpërndarjen e gjetjeve të auditorit të jashtëm duhet të krijohet dhe duhet të bëhet publike. Ngjashëm, qeveria lokale duhet të publikojë rezultatet e auditimeve të brendshme.'

19 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (2010) Mbrojtja e "sinjalizuesve, Rezoluta 1729, e miratuar më 29 prill 2010 (Mbledhja e 17-të). <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17851&lang=en>

20 Doracaku i Përmbledhur i Etikës Publike në Nivelin Lokal i Këshillit të Evropës (2006). Strasburg: Këshilli i Evropës. <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1378293&direct=true>

38. Përveç funksioneve zyrtare të auditimit, dekadat e fundit kanë parë rritje të kontrolleve sociale, veçanërisht në pjesë të Azisë dhe Afrikës. Auditimet sociale kryhen nga shoqëria civile në një lokalitet përmes qasjes në informacion prej qeverisë, angazhimit të qytetarëve dhe shqyrtimit të gjendjes në terren. Auditimet sociale janë më efektive kur ato mbështeten nga institucionet zyrtare të auditimit dhe futen në to.

2.3.2 Kodi i Etikës

39. Kodet e etikës e përshkruajnë atë që pritet nga shërbyesit publikë dhe ofrojnë një bazë të rëndësishme për të sfiduar shpërdorimin dhe korrupsionin në qeveri. Kodet e etikës duhet të mbështeten me procedura të qarta për ankesat, shqyrtimet dhe sanksionet.

40. Doracaku i Këshillit të Evropës për Etikën Publike në Nivelin Lokal potencon se:²¹

‘Sapo autoriteti lokal të miratojë një kod të veçantë të sjelljes, përfshirë sanksionet për shkelje, ai kod bëhet ligjërish i detyrueshëm dhe i zbatueshëm ndaj shkelësve. Në përputhje me qëllimin e transparencës, duhet të publikohen legjislacioni përkatës, kodi model i sjelljes dhe çdo vendim gjyqësor përkatës. Autoritetet lokale dhe zyrtarët e tyre të zgjedhur dhe të emëruar duhet të punojnë së bashku për të siguruar që kodi i sjelljes është i njohur, i promovuar dhe i zbatuar në mesin e të gjithë shërbyesve publikë lokalë.’

21 Doracaku i Përmbledhur i Etikës Publike në Nivelin Lokal i Këshillit të Evropës (2006). Strasburg: Këshilli i Evropës. <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1378293&direct=true>

2.3.3 Shqyrtimi

41. Shqyrtimi i funksioneve ekzekutive të qeverisë lokale nga përfaqësuesit e zgjedhur është një gur themeltar i rëndësishëm i qeverisjes demokratike. Ai ndihmon për të siguruar që vendimmarrësit të jenë të përgjegjshëm dhe llogaridhënës ndaj banorëve për vendimet e tyre. Shqyrtimi nga përfaqësuesit e zgjedhur plotësohet më tej përmes shqyrtimit nga banorët, shoqëria civile dhe media. Ashtu si me auditimin, kjo mund të bëhet përmes strukturave të qeverisë lokale (p.sh. mbledhjet e bashkisë/komunës, seancat e provave, komitetet e qytetarëve nën hije), ose në mënyrë të pavarur nga ajo.

3. Korniza për qeveri të hapur lokale

42. Parimet, mekanizmat dhe iniciativat e qeverisë së hapur mund të zbatohen për çdo funksion të qeverisë lokale. Në kornizën e paraqitur më poshtë dhe të detajuar në seksionet vijuese, ne prezantojmë mënyrën se si qeveria e hapur mund të zbatohet për pesë funksione të tilla: buxhetimi, kontraktimi, ligj-bërja, politikë-bërja dhe ofrimi i shërbimeve.

Funksioni	Transparenca	Pjesëmarrja	Llogaridhënia
Buxhetimi	Publiku ka qasje në informacion se si qeveria mbledh dhe shpenzon fondet publike	Publiku është i përfshirë në ndikimin ose vendosjen se si shpenzohet buxheti publik	Publiku mund të kërkojë llogari nga vendimmarrësit për mënyrën e alokimit dhe shpenzimit të parasë publike.
Kontraktimi	Publiku ka qasje në informacionin për ciklin e plotë të kontraktimit, përfshirë planifikimin, tenderin, dhënien, kontratën dhe zbatimin.	Publiku është i përfshirë në planifikimin, dhënien dhe/ose vlerësimin e zbatimit të kontratave qeveritare.	Publiku mund të kërkojë llogari nga vendimmarrësit për mënyrën e komisionimit dhe prokurimit të mallrave dhe shërbimeve.

Ligj-bërja	Publiku ka qasje në informacion se si bëhen ligjet dhe nga kush.	Publiku është i përfshirë në informimin, bërjen dhe shqyrtimin e ligjeve.	Publiku mund të kërkojë llogari nga vendimmarrësit për mënyrën e krijimit të ligjeve dhe zbatimin e tyre.
Politikë-bërja	Publiku ka qasje në informacion se si bëhen politikat dhe nga kush.	Publiku është i përfshirë në informimin, bërjen, zbatimin dhe vlerësimin e politikave.	Publiku mund të kërkojë llogari nga vendimmarrësit për mënyrën e bërjes së politikave dhe se çfarë arrijnë.
Ofrimi i shërbimeve	Publiku ka qasje në informacionin mbi të drejtat e tij, dhe qeverisjen, financimin dhe performancën e shërbimeve publike.	Publiku është i përfshirë në dizajnimin, komisionimin, ofrimin dhe vlerësimin e shërbimeve publike.	Publiku mund të kërkojë llogari nga vendimmarrësit për cilësinë dhe qasshmërinë e shërbimeve publike.

43. Ajo që vijon nuk synon të jetë gjithëpërfshirëse, por të sigurojë një vend fillestar për të eksploruar reformën e qeverisë së hapur në qeveri lokale. Secili seksion ofron historikun e temës, një pasqyrë të standardeve ndërkombëtare ose parimeve të praktikës më të mirë, një rast studimor ilustrues, rekomandime dhe burime të mëtejshme.

4. Buxhetimi i hapur lokal

4.1 Historiku

44. Qeveritë lokale nuk mund të funksionojnë pa mbledhur, alokuar dhe shpenzuar taksa nga dhe në emër të banorëve të tyre. Buxhetimi i hapur lokal është parimi që banorët duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të ndikojnë në mënyrën se si po shpenzohen paratë publike në zonën e tyre.

45. Nismat për buxhetim të hapur variojnë nga reformat e transparencës, të cilat u sigurojnë qytetarëve dhe palëve të interesit informacionin e nevojshëm për ta shqyrtuar mënyrën e alokimit dhe shpenzimit të buxheteve, deri tek reformat e pjesëmarrjes, të cilat u japin banorëve ndikim apo edhe kontroll mbi aspektet e procesit të buxhetimit.

46. Qeveritë lokale në të gjithë botën i kanë nisur reformat për buxhet të hapur, shpesh duke shkuar dukshëm më larg se homologët e tyre kombëtarë. Ndoshta shembulli më i njohur është Buxhetimi me Pjesëmarrje, ku qytetarëve u jepet fuqia për të vendosur se si të shpenzohet një buxhet, i cili u zhvillua nga qyteti brazilian i Porto Alegres.

4.2 Standarde

4.2.1 Pyetësori i anketës për buxhet të hapur nënkombëtar

47. Pyetësori i anketës për buxhet të hapur nënkombëtar i partneritetit ndërkombëtar për buxhet përcakton një sërë metrikash për matjen e hapjes së buxheteve të qeverive lokale, përfshirë gjatë formulimit, ekzekutimit dhe raportimit dhe mbikëqyrjes së buxhetit.²²

4.2.2 Parimet e pjesëmarrjes së publikut në politikën fiskale

48. Nisma globale për transparencë fiskale ka dhjetë parime për pjesëmarrjen e publikut në politikën fiskale, duke përfshirë qasshmërinë, hapjen, gjithëpërfshirjen, respektimin e vetë-shprehjes, afatin kohor, thellësinë, proporcionalitetin, qëndrueshmërinë, përputhshmërinë dhe reciprocitetin.²³

4.3 Rast studimor: Buxhetimi me pjesëmarrje në Paris, Francë

49. Në vitin 2014, Parisi realizoi ushtrimin e tij të parë të buxhetimit me pjesëmarrje, në të cilin 17.7 milion € u alokuan për nëntë projekte nga 40,745 votues. Në këtë raund pilot, propozimet ishin paraqitur nga departamentet e qytetit.

²² http://www.internationalbudget.org/wp-content/uploads/SN-OBS_Questionnaire_final020514vrquestions_em.pdf

²³ http://www.fiscaltransparency.net/pp_principles/

50. Që atëherë, procesi është rritur në madhësi dhe sofistikim. Në vitin 2015, 75 milion € ishin alokuar për 188 projekte nga 70,000 votues dhe në vitin 2016, 100 milion € ishin alokuar për 219 projekte nga 92,809 votues.

51. Edicioni i vitit 2015 pa procesin e propozimeve të hapura përtej departamenteve të qytetit për parisienët, kështu që çdo banor tani mund të sugjerojë një projekt. Në vitin 2016, u paraqitën 3,200 projekte, 624 prej të cilave u zgjodhën për t'iu dhënë votuesve. Edicioni i vitit 2016 pa një fokus të veçantë në zonat e privuara, me 30% të buxhetit të përgjithshëm të alokuar për to. Gjithashtu u aplikua një buxhet me pjesëmarrje i shkollave, në të cilin votuan 66,155 fëmijë.²⁴

4.4 Rekomandime

52. Publikoni dokumentet kryesore të buxhetit: Qeveritë lokale duhet të publikojnë dokumente kryesore të buxhetit në mënyrë që banorët dhe palët e tjera të interesit të jenë në gjendje të vëzhgojnë se si po alokohen dhe shpenzohen paratë publike.²⁵ Këto duhet të publikohen në kohën e duhur dhe në baza rutinore.

53. Krijoni buxhet të qytetarit: Qeveritë lokale duhet të krijojnë buxhet vjetor të qytetarit, i cili komunikon shifrat kryesore të buxhetit në një format të lehtë për t'u kuptuar. Kjo mund të përfshijë përdorimin e infografive ose mediave të tjera vizuale dhe/ose interaktive.²⁶

²⁴ Gjenerali më shumë: <http://www.paris.fr/actualites/the-participatory-budget-of-the-city-of-paris-4151>

²⁵ <http://www.opengovguide.com/commitments/publish-the-four-core-budget-documents/>

²⁶ <http://www.internationalbudget.org/opening-budgets/citizens-budgets/>

54. Përfshini banorët në përcaktimin e prioriteteve buxhetore: Qeveritë lokale duhet të angazhojnë banorët e tyre për të ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve për shpenzimet. Kjo mund të përfshijë mbajtjen e konsultimeve buxhetore për të informuar zhvillimin e buxhetit të lokalitetit dhe/ose për të përcaktuar një pjese të buxhetit që banorët ta alokojnë vetë përmes buxhetimit me pjesëmarrje.²⁷

²⁷ <http://guide.fiscaltransparency.net/>

5. Kontraktimi i hapur lokal

5.1 Historiku

55. Qeveritë lokale komisionojnë dhe prokurojnë një gamë të gjerë të infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve në emër të banorëve të tyre. Kontratat shpesh janë rruga përmes së cilës politikat përkthehen në përfitime të prekshme për njerëzit dhe komunitetet. Kontraktimi i hapur është parimi që banorët duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të ndikojnë në atë se çfarë qeveria lokale po kontrakton, me kë dhe për çfarë.

56. Reformat e kontraktimit të hapur variojnë nga sigurimi i më shumë informacioneve për secilën fazë të procesit të kontraktimit (d.m.th. planifikimi, tenderi, dhënia, kontrata dhe zbatimi) deri te përfshirja aktive e qytetarëve në përcaktimin, dhënien ose mbikëqyrjen e kontratave. Partneriteti për kontraktim të hapur raporton se:²⁸

“Publikimi dhe përdorimi i informacionit të strukturuar dhe të standardizuar në lidhje me kontraktimin publik mund t’u ndihmojë palëve të interesit të:

- ▶ *japin vlerë më të mirë për paratë për qeveritë,*
- ▶ *krijojnë konkurrencë më të drejtë dhe fushë lojë të barabartë për biznesin, veçanërisht firmat më të vogla,*

²⁸ Partneriteti për kontraktim të hapur (n.d.) Pse kontraktimi i hapur: Përfitimi nga kontraktimi i hapur <https://www.open-contracting.org/why-open-contracting/>

- ▶ *nxisin mallra, punë dhe shërbime me cilësi më të lartë për qytetarët,*
- ▶ *parandalojnë mashtrimet dhe korrupsionin,*
- ▶ *promovojnë analiza më të mençura dhe zgjidhje më të mira për problemet publike.*

*Kjo qasje publike në të dhëna të kontraktimit të hapur krijon besim dhe siguron që trilionat dollarë të shpenzuara nga qeveritë të rezultojnë në shërbime, mallra dhe projekte më të mira infras-
trukturore.”*

5.2 Standarde

5.2.1 Parimet globale të kontraktimit të hapur

57. Partneriteti për kontraktim të hapur ka një sërë parimesh globale të kontraktimit të hapur ‘që synojnë të udhëzojnë qeveritë dhe palët e tjera të interesit të zbulojnë në mënyrë afirmative dokumente dhe informacione në lidhje me kontraktimin publik në atë mënyrë që mundëson kuptueshmëri kuptimplotë, monitorim efektiv, performancë efikase dhe llogaridhënie për rezultatet.’²⁹ Këto mbulojnë si «zbulimin afirmativ», ashtu edhe «pjesëmarrjen, monitorimin dhe mbikëqyrjen».

5.2.2 Standardi i të dhënave të kontraktimit të hapur

58. Standardi i të dhënave të kontraktimit të hapur i partneritetit për kontraktim të hapur përcakton kërkesat për publik-

²⁹ Partneriteti për kontraktim të hapur (n.d.) Parimet globale <http://www.open-contracting.org/get-started/global-principles/>

imin e të dhënave gjatë gjithë procesit të plotë të kontraktimit, duke përfshirë planifikimin, tenderin, dhënien, kontratën dhe zbatimin.³⁰

5.3 Rast studimor: Prokurimi publik transparent - ProZorro (Ukrainë)

59. Pas revolucionit në Maidan, një bashkëpunim unik midis qeverisë, biznesit dhe shoqërisë civile, çoi në krijimin e 'ProZorro'; një sistem i e-prokurimit i dizajnuar për t'i bërë kontratat qeveritare më të hapura, për të minimizuar korrupsionin dhe për të parandaluar bashkëpunimin në proceset e prokurimit publik. ProZorro (do të thotë "transparent" në ukrainisht) u dizajnuar për t'u mundësuar organeve qeveritare të kryejnë marrëveshje të prokurimit në mënyrë elektronike, ndërsa qasjen në informata të kontratave publike e bën më të lehtë për qytetarët, gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile duke iu mundësuar atyre të gjurmojnë aktivitetet e prokurimit të organeve publike.

60. Në përputhje me standardin e të dhënave të kontraktimit të hapur, sistemi ruan informacione për të gjitha pjesët e procesit të kontraktimit - nga planifikimi deri te pagesat e bëra pas përfundimit. Informacioni i paraqitur në një ueb-portal të hulumtueshëm, të drejtuar nga qeveria, ku autoritetet e prokurimit gjithashtu mund të publikojnë njoftimet e tyre për tender dhe planet e prokurimit. Procesi real i tenderimit kryhet përmes një serie sajtesh të veçanta (pak të lidhura) për tenderë komercialë, të përshtatura për nevojat e blerësve dhe furnizuesve.

30 <https://www.open-contracting.org/data-standard/>

61. Ai gjithashtu përfshin mjete për të analizuar të dhënat e tenderëve, një mekanizëm ankesash për ofertuesit (me rezultatin e ankesave të publikuara në internet), një portal informacioni me udhëzues trajnimi për bazat e prokurimit dhe ligjet përkatëse, dhe një platformë monitorimi që u mundëson prokuruesve dhe furnizuesve të vlerësojnë përvojat e tyre me njëri-tjetrin dhe një rrugë për publikun e gjerë një mënyrë për të raportuar marrëveshje të dyshimta tek autoritetet.

62. Pas një periudhe pilot vullnetare, parlamenti i Ukrainës miratoi një ligj të prokurimit publik që kërkon që të gjitha kontraktimet qeveritare të kryhen duke përdorur ProZorro nga 1 gushti 2016. Që nga ajo kohë, përdorimi i ProZorro ka rezultuar në rritje të pjesëmarrjes dhe konkurrencës për tenderë publikë dhe në përmirësim të besimit të biznesit dhe publikut në drejtësinë e proceseve të prokurimit publik të Ukrainës.³¹

5.4 Rekomandime

63. Publikoni dokumentacionin dhe të dhënat kryesore: Qeveritë lokale duhet të publikojnë informacione nga kontratat që nënshkruajnë, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me sasi të mëdha ose shërbime ose infrastrukturë kritike, për t'u shqyrtuar nga banorët dhe palët e tjera të interesit.³²

64. Miratoni standardin e të dhënave të kontraktimit të hapur: Qeveritë lokale duhet të nënshkruajnë dhe miratojnë Standardin ndërkombëtar të të dhënave të kontraktimit të hapur dhe të publikojnë informacionin dhe të dhënat në lidhje me

³¹ Gjenerali më shumë: <https://medium.com/open-contracting-stories/everyone-sees-everything-fa6df0d00335>

³² <http://www.opengovguide.com/commitments/publish-key-documents-and-data/>

kontratat publike në përputhje me rrethanat. Qeveritë lokale duhet të shqyrtojnë, në mënyrë ideale, përmes një vlerësimi të pavarur, pajtueshmërinë e tyre me standardet në intervale të rregullta.³³

65. Përfshini qytetarët në shërbimet e komisionimit: Qeveritë lokale duhet të përfshijnë banorët e tyre në përcaktimin, dhënien dhe vlerësimin e kontratave, veçanërisht kur ato kanë të bëjnë me shërbimet ose infrastrukturën thelbësore.³⁴

33 <https://www.open-contracting.org/data-standard/>

34 <http://www.opengovguide.com/commitments/involve-citizens-in-the-commissioning-design-delivery-and-assessment-of-public-services/>

6. Ligj-bërja lokale e hapur

6.1 Historiku

66. Qeveritë lokale shpesh janë përgjegjëse për hartimin ose zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve. Ligj-bërja e hapur është parimi që banorët duhet ta dinë dhe të ndikojnë në ato vendime që marrin përfaqësuesit e tyre të zgjedhur, pse dhe si, dhe të jenë në gjendje t'i mbajnë ata përgjegjës për to. Reformat për ligj-bërje të hapur variojnë nga sigurimi i qytetarëve me më shumë informacione në lidhje me procesin e ligj-bërjes dhe qasjen në forume vendimmarrëse, deri te përfshirja e tyre aktive në informimin ose shqyrtimin e një vendimi.

6.2 Standarde

67. Deklarata e Hapjes Parlamentare, e zhvilluar nga anëtarët e OpeningParlament.org, përcakton standardet për hapjen parlamentare rreth katër temave:

- ▶ Promovimi i një kulture të hapjes
- ▶ Bërja transparent e informacionit parlamentar
- ▶ Lehtësimi i qasjes në informacionin parlamentar
- ▶ Mundësimi i komunikimit elektronik të informacionit parlamentar

6.3 Rast studimor: Decide Madrid, Spanjë

68. Decide Madrid është ueb-platforma e Këshillit të Qytetit të Madridit për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Një nga katër funksionet kryesore të platformës është të sigurojë një forum për çdo banor që të propozojë ligj të ri lokal të cilin banorët e tjerë mund ta votojnë për ta mbështetur. Propozimet që fitojnë mbështetje nga një për qind të popullsisë së regjistrimit vihen në votim të detyrueshëm publik. Pas kësaj, këshilli ka një muaj për të hartuar raporte teknike mbi ligjshmërinë, realizueshmërinë dhe koston e propozimeve të suksesshme, të cilat publikohen në platformë.

69. Votimi i parë për propozimet e suksesshme të qytetarëve u zhvillua në shkurt 2017, kur banorët e Madridit votuan për “Madrid 100% të qëndrueshëm” dhe “Biletë njëdrejtimëshe për transportin publik”. Të dy propozimet u miratuan, duke fituar 94% (198,905 vota) dhe respektivisht 89% (188,665 vota) mbështetje, dhe qyteti që atëherë ka publikuar dokumente teknike për të dy.

70. Sikurse propozimet dhe votimi, edhe platforma Decide Madrid mbështet debate dhe buxhetim me pjesëmarrje.³⁵

6.4 Rekomandime

71. Publikoni informacione në një format të qasshëm në lidhje me procesin e vendimmarrjes, agjendat dhe procesverbalet: Qeveritë lokale duhet të sigurojnë informacion të qasshëm për procesin e vendimmarrjes demokratike. Kjo duhet t’u

³⁵ Gjenerali më shumë: <https://decide.madrid.es/>

mundësojë banorëve dhe palëve të tjera të interesit të kuptojnë se çfarë vendimesh po merren në emër të tyre, kur dhe nga kush dhe si janë arritur vendimet përfundimtare.³⁶

72. Hapini mbledhjet e këshillit për anëtarët e publikut, shoqërinë civile dhe qasjen e shtypit për të marrë pjesë dhe raportuar për: Qeveritë lokale duhet t'u mundësojnë banorëve dhe palëve të tjera të interesit të marrin pjesë, të mbajnë shënime dhe të raportojnë në takimet e përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, përveç nëse ekziston një rast i jashtëzakonshëm për mbajtjen e një takimi privatisht. Qeveritë lokale duhet të përcaktojnë qartë të drejtën e banorëve dhe të tjerëve për të marrë pjesë, si dhe kriteret për përjashtime.³⁷

73. Mundësojuni qytetarëve të propozojnë dhe votojnë ligje lokale: Qeveritë lokale duhet t'i përfshijnë banorët në informimin e vendimeve dhe procesin e vendimmarrjes, dhe të krijojnë një mekanizëm të qartë përmes të cilit vetë banorët mund të propozojnë dhe/ose të votojnë për ligje të reja.³⁸

36 <https://www.openingparliament.org/declaration/>

37 <https://www.gov.uk/government/publications/open-and-accountable-local-government-plain-english-guide>

38 <http://participedia.net/en/methods/initiative-process>

7. Politikë-bërja lokale e hapur

7.1 Historiku

74. Puna e qeverisë lokale udhëhiqet nga procesi i politikë-bërjes, i cili e përkthen ambicien politike në plane dhe shërbime praktike. Politikë-bërja e hapur është parimi që banorët duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të ndikojnë në ato vendime që merren në emër të tyre, nga kush dhe si.

75. Reformat për politikë-bërje të hapur variojnë nga ofrimi i qasjes së qytetarëve në informacion në lidhje me formulimin e politikave deri te përfshirja aktive e tyre në zhvillimin e saj. Pjesëmarrja e publikut në politikë-bërje mund të bëhet në çdo fazë të procesit të politikave. Për shembull, tabela më poshtë përshkruan disa nga metodat e pjesëmarrjes publike që mund të zbatohen në faza të ndryshme të ciklit të politikave:

Faza e politikave	Shembuj të metodave
Përcaktimi i agjendës	<ul style="list-style-type: none">• Iniciativa qytetare• Forume diskutimi• Kërkime për të ardhmen• Buxhetimi me pjesëmarrje• Vizionimi

Formimi i politikave	<ul style="list-style-type: none"> • Panele qytetare • Kontraktimi i turmës (crowdsourcing) • Forume diskutimi • Fokus grupe • Shërbime anketuese
Vendimmarrja	<ul style="list-style-type: none"> • Asamble qytetare • Juri qytetare • Konferenca konsensusi • Konsultime publike • Referendume
Zbatimi	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkë-komisionimi • Bashkë-krijimi • Bashkë-dizajnimi i shërbimeve • Panele përdoruesish
Monitorimi dhe vlerësimi	<ul style="list-style-type: none"> • Kartela raporti të qytetarëve • Mekanizma ankesash • Blerës të fshehtë • Anketa

7.2 Standarde

76. Vlerat Thelbësore të Shoqatës Ndërkombëtare për Pjesëmarrje Publike (IAP2) për Praktikën e Pjesëmarrjes Publike i përcaktojnë shtatë parime kryesore për praktikën e pjesëmarrjes publike:

- a. Pjesëmarrja e publikut bazohet në besimin se ata që preken nga një vendim kanë të drejtë të përfshihen në procesin e vendimmarrjes.
- b. Pjesëmarrja e publikut përfshin premtimin se kontributi i publikut do të ndikojë në vendim.
- c. Pjesëmarrja publike promovon vendime të qëndrueshme duke njohur dhe komunikuar nevojat dhe

interesat e të gjithë pjesëmarrësve, përfshirë vendim-marrësit.

- d. Pjesëmarrja e publikut kërkon dhe lehtëson përfshirjen e atyre që potencialisht preken ose janë të interesuar në ndonjë vendim.
- e. Pjesëmarrja e publikut kërkon kontribut nga pjesëmarrësit në modelimin se si marrin pjesë.
- f. Pjesëmarrja e publikut u siguron pjesëmarrësve informacionin që u nevojitet për të marrë pjesë në një mënyrë kuptimplote.
- g. Pjesëmarrja e publikut u komunikon pjesëmarrësve se si kontributi i tyre ndikoi në vendim.³⁹

7.3 Rast studimor: Politika e pjesëmarrjes rajonale në Tuscany, Itali

77. Politika e pjesëmarrjes rajonale në Tuscany (TTPR) institucionalizon proceset pjesëmarrëse, diskutuese si pjesë e rregullt e administratës dhe qeverisjes në tërë Tuscany. U aplikua në ligjin rajonal të Tuscany-s në vitin 2007 dhe u forcuar në vitin 2013, qëllimi kryesor i TTPR-së është, siç deklarohet në Nenin 1 Nr. 46/2013, “kontributi në ripërtëritjen e demokracisë dhe institucioneve të veta duke integruar ato me praktika, procese dhe mjete të demokracisë pjesëmarrëse”, dhe, përmes kësaj, të zhvillojë “kohezion më të madh shoqëror, përmes përhapjes së një kulture pjesëmarrëse, dhe vlerësimit të të gjitha formave të angazhimit qytetar, njohurive dhe shkathtësive të shpërndara në shoqëri”.

³⁹ <http://www.iap2.org/?page=A4>

78. Ligji vazhdon të krijojë detyrim për qeveritë lokale dhe rajonale për të zhvilluar procese të ndryshme pjesëmarrëse për angazhimin e qytetarëve në ndërtimin e politikave dhe projekteve publike. Këto detyrime bazohen në parimin se pjesëmarrja është e drejtë themelore e njeriut dhe është përgjegjësi e institucioneve publike të ofrojnë mundësi për këtë dhe të sigurojnë që ekzistojnë mjetet e duhura për të mundësuar pjesëmarrje efektive.

79. Ligji parashikoi edhe krijimin e një institucioni të pavarur të ngarkuar me promovimin e proceseve pjesëmarrëse: "Autoriteti për pjesëmarrje". Ky organ ka rolin e monitorimit të zhvillimit të një kulture më pjesëmarrëse në të gjithë rajonin dhe të shpërndarjes së fondeve për të mbështetur qasjet inovative metodologjike të pjesëmarrjes (përfshirë përdorimin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit) për të mundësuar zhvillimin e formave të reja të shkëmbimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve.⁴⁰

7.4 Rekomandime

80. Publikoni informacione në format të qasshëm për procesin e hartimit të politikave, përfshirë informacione të përditësuara për proceset aktuale të politikave: Qeveritë lokale duhet të sigurojnë informacion të qasshëm për procesin e politikë-bërjes. Kjo duhet t'u mundësojë banorëve dhe palëve të tjera të interesit të kuptojnë se çfarë politikash po bëhen në emër të tyre, kur dhe nga kush dhe si janë arritur politikat përfundimtare.⁴¹

40 Gjени më shumë: <http://participedia.net/en/cases/tuscany-regional-participation-policy-italy>

41 <http://www.opengovguide.com/commitments/publish-core-information-about-government-on-a-proactive-basis/>

81. Angazhoni banorët në çështje me prioritet të lartë: Qeveritë lokale duhet të identifikojnë çështje me prioritet të lartë për banorët, dhe t'i përfshijnë ata në zhvillimin, shqyrtimin dhe/ose vendosjen e opsioneve të politikave. Procesi duhet të pasqyrojë një dëshirë të mirëfilltë për t'u angazhuar, të dizajnohet në përputhje me parimet e praktikës së mirë dhe të përfshijë informata kthyesë për banorët mbi rezultatin.⁴²

82. Zhvilloni dhe zbatoni politikë të pjesëmarrjes së këshillit: Qeveritë lokale duhet të bëjnë përpjekje për të përfshirë pjesëmarrjen e publikut në mënyrën e punës që bëjnë. Kjo mund të marrë formën e një politike të pjesëmarrjes së këshillit që e përcakton kërkesën për angazhimin e banorëve, e cila u komunikohet banorëve dhe që është ligjërisht e zbatueshme.⁴³

42 <http://www.opengovguide.com/commitments/engage-citizens-in-deliberation-on-a-priority-issue/>

43 <http://www.opengovguide.com/commitments/establish-legislation-and-guidelines-on-public-consultation-in-policy-development/>

8. Ofrimi i shërbimeve lokale të hapura

8.1 Historiku

83. Sigurimi i shërbimeve publike është funksion kritik i qeverive lokale. Banorët mbështeten në këto shërbime që janë të qasshme dhe me cilësi të lartë për mirëqenien e tyre dhe të familjes së tyre. Shërbimet e hapura publike është parimi që banorët duhet të jenë në gjendje të dinë dhe të ndikojnë në mënyrën se si po funksionojnë shërbimet publike në zonën e tyre.

84. Reformat në shërbimet e hapura publike variojnë nga sigurimi i informacionit mbi të drejtën e banorëve për shërbime dhe standardet e tyre, deri tek përfshirja aktive e përdoruesve të shërbimeve në dizajnimin, ofrimin dhe/ose shqyrtimin e tyre. Partneriteti për qeveri të hapur raporton se:⁴⁴

“Reformat në shërbimet e hapura publike mund të zbatohen në faza të ndryshme të ciklit të politikave; për shembull:

- ▶ *Identifikimi i prioriteteve dhe përcaktimi i agjendës - d.m.th. angazhimet për zhvillimin e*

⁴⁴ Hughes, T; Scott, K; & Maassen, P. (2017) Përmirësimi i Shërbimeve Publike: Udhëzime për zhvillimin e angazhimeve të PQH-së. Uashington DC: Partneriteti për qeveri të hapur. https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/OGP_public-service-guidance.pdf

mekanizmave që sjellin zërin e qytetarëve në vendime për prioritetizimin e çështjeve dhe/ose alokimin e burimeve (p.sh. në buxhetimin me pjesëmarrje).

- ▶ *Politikë-bërja dhe dizajnimi i shërbimeve - d.m.th. angazhimet që sjellin zërin e qytetarëve në proceset e politikave që lidhen me shërbimet publike dhe/ose përfshijnë qytetarë në dizajnimin e shërbimeve*
- ▶ *Bashkë-komisionimi dhe bashkë-krijimi - d.m.th. angazhimet që përfshijnë qytetarët në vendim-marrjet e komisionimit dhe/ose ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve publike*
- ▶ *Monitorimi dhe llogaridhënia - d.m.th. angazhimet që përfshijnë qytetarët në vlerësimin e performancës së shërbimeve publike dhe llogaridhënies së ofruesve për shërbimet e tyre "*

8.2 Standarde

85. Udhëzimet e partneritetit për qeveri të hapur rekomandojnë një qasje me gjashtë hapa për zhvillimin e reformave/angazhimeve për shërbime të hapura publike:

- a. Angazhoni qytetarët dhe shoqërinë civile në përzgjedhjen e një shërbimi prioritar dhe në përcaktimin e problemit, reforma ose iniciativa do ta trajtojë atë.
- b. Zbuloni dhe kuptoni kontekstin dhe sistemin në të cilin do të zbatohet reforma ose iniciativa, duke përfshirë disponueshmërinë dhe përdorimin e burimeve, palët e interesuara shtetërore dhe jo-shtetërore, marrëdhëniet e pushtetit dhe mekanizmat ekzistues të angazhimit dhe llogaridhënies.

- c. Angazhoni qytetarët, specialistët e sektorit dhe ekspertët për llogaridhënie sociale - nga shoqëria civile kombëtare, akademia, OJQ-të ndërkombëtare dhe/ose organizata shumëpalëshe - deri tek ndihma për dizajnimin e reformës ose iniciativës.
- d. Angazhoni mbikëqyrje përkatëse (inspektorate, etj.), auditim, Avokat të Popullit dhe/ose institucione parlamentare në eksplorimin se si reforma ose iniciativa mund të futet në proceset ekzistuese të llogaridhënies.
- e. Angazhoni median, organizatat e shoqërisë civile, lëvizjet shoqërore dhe grupe të tjera për të rritur ndërgjegjësimin për reformën ose iniciativën, dhe mobilizoni qytetarë për të marrë pjesë.
- f. Bashkëpunoni me akademikë dhe partnerë shumëpalësh për të vlerësuar ndikimin e reformës ose iniciativës.

8.3 Rast studimor: MH:2K - Shëndeti Mendor i të Rinjve në Oldham, MB

86. Kushtet e shëndetit mendor prekin rreth 1 në 10 të rinj në MB, me grupe të cënueshme veçanërisht të rrezikuara. MH:2K u krijua nga Involve and Leaders Unlocked për të angazhuar të rinjtë në biseda rreth shëndetit mendor në zonën e tyre lokale. Ai fuqizon 14-25 vjeçarët për të identifikuar çështjet e shëndetit mendor që ata i shohin si më të rëndësishme; angazhoni bashkëmoshatarët e tyre në diskutimin dhe eksplorimin e këtyre temave; dhe bashkëpunoni me vendimmarrësit kryesorë lokalë për të dhënë rekomandime për ndryshime.

87. Modeli MH: 2K përbëhet nga gjashtë përbërës kryesorë:

- a. Rekrutimi i një ekipi kryesor të të rinjve si 'Studiues Qytetarë', përfshirë ata me përvojë të drejtpërdrejtë në çështje të shëndetit mendor dhe individë nga grupet e rrezikuara.
- b. Ditët e dizajnit për t'i mundësuar këtij ekipi të eksplorojë informacione kyçe kombëtare dhe lokale në lidhje me shëndetin mendor të të rinjve, së bashku me pikëpamjet dhe përvojat e tyre. Studiuesit përcaktojnë se cilat çështje të shëndetit mendor janë më domethënëse për zonën e tyre. Ata trajtohen në hulumtime, lehtësime dhe komunikim publik.
- c. Turne: Studiuesit Qytetarë bashkë-dizajnojnë dhe bashkë-realizojnë punëtori për të angazhuar të paktën 500 të rinj të tjerë në temat që ata i kanë identifikuar se janë më të rëndësishmet për zonën e tyre. Punëtoritë stimulojnë të mësuarit joformal dhe mbledhin pikëpamjet e të rinjve mbi çështjet dhe zgjidhjet e mundshme.
- d. Dita e rezultateve: Studiuesit Qytetarë ndihmojnë në analizimin dhe nxjerrjen e gjetjeve kryesore. Ata punojnë me vendimmarrësit lokalë për të zhvilluar rekomandime të forta dhe praktike për ndryshime.
- e. Ekspozitë e madhe: Studiuesit Qytetarë i prezantojnë gjetjet dhe rekomandimet e tyre për palët kryesore të interesit në një ngjarje ekspozite, duke përfshirë biseda të lehtësuara për hapat e ardhshëm.
- f. Panel ekspertësh i vendimmarrësve kryesorë lokalë dhe i palëve të interesit që japin informata për punën e projektit gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

88. Procesi u pilotua në Oldham, një qytet në veri-perëndim të Anglisë, midis shtatorit 2016 dhe majit 2017. Njëzet të rinj të rritur me prejardhje të ndryshme u rekrutuan për t'u bërë MH:2K të parë: Studiues Qytetarë. Të pajisur me njohuri dhe

mbështetje të duhur, Studiuesit Qytetarë zgjedhën pesë prioritete kryesore për t'i adresuar përmes pilotit: Vetë-dëmtimi; Stigmatizimi; Praktika profesionale; Familja dhe marrëdhëniet; Mjedisi; dhe Kultura e Arsimit. Projekti do të provohet në katër zona të reja në 2017/18.⁴⁵

8.4 Rekomandime

89. Publikoni dhe promovoni informacion mbi shërbimet publike për të cilat banorët kanë të drejtë: Qeveritë lokale duhet të informojnë banorët e tyre për shërbimet që kanë të drejtë të marrin dhe standardet që duhet të presin. Kjo duhet t'u mundësojë banorëve dhe palëve të tjera të interesit të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre dhe t'i mbajnë përgjegjës ofruesit e shërbimeve për nivelin e shërbimit që ata marrin.

90. Mblidhni informata kthyesë mbi kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet publike: Qeveritë lokale duhet të mbledhin informatat kthyesë nga banorët dhe të veprojnë në mënyrë rutinore për cilësinë dhe qasshmërinë në shërbimet që marrin. Kjo mund të ndodhë në pikën e ofrimit të shërbimeve dhe/ose përmes proceseve më të gjera të angazhimit.

91. Përfshini qytetarët në dizajnimin dhe ofrimin e shërbimeve publike: Qeveritë lokale duhet të përfshijnë banorët, veçanërisht përdoruesit e shërbimeve, gjatë shqyrtimit, dizajnit dhe ofrimit të shërbimeve publike. Procesi duhet të pasqyrojë një gatishmëri të mirëfilltë për të vepruar në bazë të informatave kthyesë dhe ideve të banorëve, të dizajnohet në përputhje me parimet e praktikës së mirë dhe të përfshijë informata kthyesë për banorët mbi rezultatin.

⁴⁵ Gjenerali më shumë: <http://www.involve.org.uk/programmes/mh2k/>

9. Rekomandimet për qeveri të hapur lokale

92. Qeveria e hapur kalon nëpër përpjekjet e Këshillit të Evropës për të promovuar të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Në kontekstin e qeverisë lokale, parimet dhe praktikatat e qeverisë së hapur përputhen veçanërisht me '12 Parimet e Qeverisjes së Mirë Demokratike në Nivelin Lokal' të Këshillit të Evropës (shih 1.3.1 më lart).

93. Më poshtë janë përshkruar disa rekomandime për mënyrën se si Këshilli i Evropës mund të mbështesë më tej zhvillimin e qeverisë së hapur lokale brenda vendeve anëtare të tij.

94. Zhvilloni dhe promovoni standarde ndërkombëtare të qeverisë së hapur të zbatueshme për qeveritë lokale. Ekzistojnë tashmë një numër standardesh ndërkombëtare për qeveri të hapur, siç u përshkruan në seksionet e mëparshme. Aty ku ekzistojnë këto, Këshilli i Evropës mund të luajë rol të rëndësishëm në ndihmën për shpërndarjen e tyre në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës. Sidoqoftë, ka boshllëqe në standardet ekzistuese, veçanërisht në zbatimin e tyre në qeveri lokale. Këshilli i Evropës mund të luajë rol të rëndësishëm në ndihmën për të mbuluar këto boshllëqe.

95. Siguroni asistencë teknike për qeveritë lokale dhe rajonale në zbatimin e mekanizmave për qeveri të hapur. Reformat

në qeveri të hapur mund të kërkojnë ekspertizë të konsiderueshme teknike për t'u zbatuar. Këshilli i Evropës mund të luajë rol kritik për përputhjen e burimeve të ekspertizës me kërkesë të qeverisë lokale, qoftë përmes mentorimit, trajnimit ose konsultimit. Kur ka zona me interes të përbashkët në shumë qeveri lokale, Këshilli i Evropës mund të ndihmojë për të mbledhur forume në të cilat praktika mund të ndahet dhe diskutohet.

96. Mbështesni shkëmbimin mes kolegëve dhe të mësuarit midis qeverive lokale duke iniciuar reforma në qeveri të hapur. Sa i përket ekspertizës teknike, Këshilli i Evropës mund të mbështesë shkëmbimin mes kolegëve midis qeverive lokale në vendet e tij anëtare. Ekzistojnë fusha të ekspertizës së konsiderueshme në qeveritë lokale mbi realitetet e zbatimit të reformave në qeveri të hapur, të cilat mund të ndahen me qeveritë lokale në një fazë të hershme të zhvillimit.

97. Inkurajoni anëtarësimin në partneritetin e qeverisë së hapur dhe forume të tjera ndërkombëtare. Ekzistojnë tashmë një numër forumesh ndërkombëtare, nga të cilat partneriteti i qeverisë së hapur është më i spikaturi, që e mbështesin praktikën e qeverisë së hapur në nivel kombëtar dhe nënkombëtar. Këshilli i Evropës mund të ndihmojë në inkurajimin dhe mbështetjen e anëtarësimit në iniciativa të tilla nga qeveritë lokale në vendet e tij anëtare.

SHTOJCA: LEXIM SHITESË

1 Elemente përshkuese të qeverisë së hapur

1.1 Qasja në informacion

- E drejta në informacion - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/right-to-info/>
- E drejta e publikut për të ditur – Parimet mbi legjislacionin për lirinë e informacionit - Neni 19: <http://www.article19.org/data/files/pdfs/standards/righttoknow.pdf>
- Liria e informacionit: Manuali i trajnimit për zyrtarë publikë - Neni 19: https://www.ip-rs.si/fileadmin/user_upload/Pdf/Publikacije_ostalih_pooblascencev/Article_19_foitainers-manual.pdf

1.2 Të dhëna të hapura

- Karta e të Dhënave të Hapura: <http://opendatacharter.net>
- Doracaku i të Dhënave të Hapura - Open Knowledge International: <http://opendatahandbook.org>
- Udhëzime praktike të të Dhënave të Hapura - Fondacioni i Rrjetit: <http://webfoundation.org/about/research/open-data-how-to-guides/>
- Të dhëna për qeveri të hapur - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/open-government-data/>
- Paketë e të dhënave për qeveri të hapur - Banka Botërore: <http://opendatatoolkit.worldbank.org/en/>

1.3 Menaxhimi i regjistrave

- Mjeti i vlerësimit të zbatimit të qasjes në informacion - The Carter Center: <https://www.cartercenter.org/peace/ati/iat/index.html>
- Liria e informacionit: Manuali i trajnimit për zyrtarë publikë
 - Neni 19: https://www.ip-rs.si/fileadmin/user_upload/Pdf/Publikacije_ostalih_pooblascencev/Article_19_foitainers-manual.pdf
- Parimet e përgjithshme të pranuar të mbajtjes së regjistrave
 - ARMA International: http://www.arma.org/docs/share-point-roadshow/the-principles_executive-summaries_final.doc
- Integrimi i menaxhimit të regjistrave në sisteme të TIK-ut: Treguesit e praktikave të mira - International Records Management Trust: http://www.irmt.org/documents/educ_training/term%20resources/IRMT_Good_Practice_Indicators.pdf
- Menaxhimi i regjistrave - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/records-management/>

1.4 Hapësira qytetare

- Monitorimi nga Civicus - Civicus: <https://monitor.civicus.org>
- Kodi i Praktikës së Mirë për Pjesëmarrje Civile në Procesin e Vendim-marrjes - KiE: <http://www.coe.int/en/web/ingo/civil-participation>
- Mbrojtja e Shoqërisë Civile - Lëvizja Botërore për Demokraci: <http://www.defendingcivilsociety.org>
- Raporti i Gjendjes së Shoqërisë Civile 2017 - Civicus: <http://www.civicus.org/index.php/state-of-civil-society-report-2017>
- Korniza e Vlerësimit të Gjendjes së Demokracisë Lokale - IDEA: <http://www.idea.int/publications/catalogue/state-local-democracy-assessment-framework>

1.5 Angazhimi qytetar

- Pjesëmarrja civile në proceset e vendim-marrjes - Pasqyrë e Standardeve dhe Praktikave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës - Këshilli i Evropës: <https://rm.coe.int/16806fa094>
- CLEAR: Pjesëmarrja qytetare - Këshilli i Evropës: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=2961724&SecMode=1&DocId=2010906&Usage=2>
- Kodi i Praktikës së Mirë për Pjesëmarrje Civile në Procesin e Vendim-marrjes - KiE: <http://www.coe.int/en/web/ingo/civil-participation>
- Baza e njohurive - Involve: <http://www.involve.org.uk/knowledge-base/>
- Pako e qeverisjes pjesëmarrëse - Civicus: <http://www.civicus.org/index.php/media-center/toolkits/611-participatory-governance-toolkit>
- Participedia: <http://participedia.net>
- Udhëzime burimore për angazhim të publikut - NCDD: http://www.ncdd.org/files/NCDD2010_Resource_Guide.pdf

1.6 Mbrojtja e sinjalizuesve

- Angazhimi në mbrojtjen efektive të sinjalizuesve - OBZHE: <http://www.oecd.org/corruption/committing-to-effective-whistleblower-protection-9789264252639-en.htm>
- Praktikrat më të mira ndërkombëtare për politika sinjalizuesish - Projekti qeveritar për llogaridhënie: <https://www.whistleblower.org/international-best-practices-whistleblower-policies>

- Rekomandimi CM/Rec(2014)7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve - Këshilli i Evropës: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016805c5ea5
- Parimet globale për siguri kombëtare dhe të drejtat në informacion (Parimet e Tshwane): <https://www.opensocietyfoundations.org/publications/global-principles-national-security-and-freedom-information-tshwane-principles>

1.7 Auditimi

- Qeverisja llogaridhënëse - OBZHE: <http://www.oecd.org/gov/ethics/public-sector-accountability.htm>
- Doracaku për etikë publike në nivel lokal - Këshilli i Evropës: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1378293&direct=true>
- Udhëzimi për fushat e shpenzimeve publike dhe llogaridhënies financiare - Banka Botërore: <http://siteresources.worldbank.org/PEFA/Resources/PEFAFieldguide.pdf>
- Standardet e auditimit të brendshëm të sektorëve publikë
 - CIPFA: <http://www.cipfa.org/policy-and-guidance/standards/public-sector-internal-audit-standards>
- Roli i auditimit në qeverisjen e sektorëve publikë - Instituti i Auditorëve të Brendshëm: https://na.theiia.org/standards-guidance/Public%20Documents/Public Sector Governance1_1 .pdf

1.8 Kodi i Etikës

- Doracaku për etikë publike në nivel lokal - Këshilli i Evropës: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?p=&id=1378293&direct=true>

- Menaxhimi i konfliktit të interesit në sektorin publik - OBZHE: <http://www.oecd.org/gov/ethics/48994419.pdf>
- Parimet për menaxhimin e etikës në shërimin publik - OBZHE: <http://www.oecd.org/gov/ethics/oecdprinciplesformanagingethicsinthepublicservice.htm>
- Vlerësimi i etikës publike - Këshilli i Evropës: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=2961841&SecMode=1&DocId=1910774&Usage=2>
- 7 parimet e jetës publike: <https://www.gov.uk/government/publications/the-7-principles-of-public-life/the-7-principles-of-public-life--2>
- Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit: http://www.unodc.org/documents/treaties/UNCAC/Publications/Convention/08-50026_E.pdf

1.9 Shqyrtimi

- Udhëzues praktik: Hyrje në shqyrtim - Qendra për Shqyrtim Publik: <http://www.cfps.org.uk/practice-guide-an-introduction-to-scrutiny/>

2. Buxhete të hapura

- Buxhetet - Open Government Guide: <http://www.opengov-guide.com/topics/budgets/>
- Pako e të dhënave fiskale të hapura - Iniciativë globale për transparencë fiskale: <http://www.fiscaltransparency.net/ofdp/>
- Udhëzimi i parimeve për pjesëmarrje publike - Iniciativë globale për transparencë fiskale: <http://guide.fiscaltransparency.net/>

- Transparencë nënkombëtare e buxhetit - Partneriteti ndërkombëtar për buxhet: <http://www.internationalbudget.org/opening-budgets/open-budget-initiative/subnational-work/>
- Fuqia e thjeshtësimit: Udhëzim qeverie për zhvillim të buxheteve të qytetarëve - Partneriteti ndërkombëtar për buxhet: <http://www.internationalbudget.org/publications/the-power-of-making-it-simple-a-government-guide-to-developing-citizens-budgets/>

3. Kontraktimi i hapur

- Kontraktimi publik - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/public-contracting/>
- Partneriteti për kontraktim të hapur: <http://www.open-contracting.org/why-open-contracting/>

4. Ligj-bërja e hapur

- Deklaratë për hapje parlamentare - OpenParliament.org: <https://www.openingparliament.org/declaration/>
- Parlamentet - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/parliaments/>

5. Politikë-bërja e hapur

- Angazhimi qytetar - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/citizen-engagement/>
- Pjesëmarrja civile në proceset e vendim-marrjes - Pasqyrë e standardeve dhe praktikave në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës - KiE: <https://rm.coe.int/16806fa094>
- CLEAR: Pjesëmarrja qytetare - KiE: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=2961724&SecMode=1&Do->

[cld=2010906&Usage=2](#)

- Baza e njohurive - Involve: <http://www.involve.org.uk/knowledge-base/>
- Pako e qeverisjes pjesëmarrëse - Civicus: <http://www.civicus.org/index.php/media-center/toolkits/611-participatory-governance-toolkit>
- Participedia: <http://participedia.net>
- Udhëzime burimore për angazhim të publikut - NCDD: http://www.ncdd.org/files/NCDD2010_Resource_Guide.pdf

6 Ofrimi i shërbimeve të hapura

- Përmirësimi i shërbimeve publike: Udhëzime për zhvillimin e angazhimeve të PQH-së - Partneriteti për qeveri të hapur: https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/OGP_public-service-guidance.pdf
- Shërbime publike - Open Government Guide: <http://www.opengovguide.com/topics/public-services/>
- Pako e qeverisjes pjesëmarrëse - Civicus: <http://www.civicus.org/index.php/media-center/toolkits/611-participatory-governance-toolkit>

Duke pasur parasysh rreziqet e korrupsionit ndaj të cilave janë të ekspozuara autoritetet lokale dhe rajonale, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës inkurajon autoritetet lokale dhe rajonale të zhvillojnë dhe zbatojnë konceptin e "qeverisjes së hapur".

Raporti i miratuar nga Kongresi detajon tre parimet e qeverisjes së hapur – transparencë, pjesëmarrje dhe llogaridhënie – që mund dhe duhet të zbatohen në funksionimin e autoriteteve lokale dhe rajonale.

Ky raport është pjesë e udhërrëfyesit të Kongresit mbi aktivitetet për parandalimin e korrupsionit dhe promovimin e etikës publike në nivele lokale dhe rajonale. Objektivi është të ofrojë një sërë përgjigjesh praktike ndaj sfidave me të cilat përbalen autoritetet lokale dhe rajonale.

SQI

www.coe.int

The Council of Europe is the continent's leading human rights organisation. It comprises 47 member states, including all members of the European Union. The Congress of Local and Regional Authorities is an institution of the Council of Europe, responsible for strengthening local and regional democracy in its 47 member states. Composed of two chambers – the Chamber of Local Authorities and the Chamber of Regions – and three committees, it brings together 648 elected officials representing more than 200 000 local and regional authorities.